

Kujt i drejtohet kjo broshurë?

Kjo broshurë ofron ndihmë dhe këshilla për personat që mendojnë se mund të jenë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në MB.

Çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore?

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë. Dikush trafikohet nëse çohet (ose transferohet brenda një vendi) në një shtet nga persona që e kërcënojnë, e lëndojnë ose e detyrojnë të punojë ose të bëjë gjëra të tjera që nuk dëshiron t'i bëjë.

Nëse identifikohesh si viktimë e trafikimit, atëherë ke të drejtë për:

- Ndihmë dhe mbrojtje nga qeveria e MB-së (ky quhet Mekanizimi Kombëtar i Referimit). E gjithë mbështetja jepet në mënyrë konfidenciale.
- Mbështetje nëse vendos të flasësh me policinë.

Mekanizmi Kombëtar i Referimit është krijuar për të identifikuar viktimat e trafikimit dhe për t'i referuar ato në organizatat që mund të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.

Individët e identifikuar si viktima të trafikimit kanë të drejtë për një periudhë minimale rikuperimi dhe reflektimi prej 45 ditësh. Si pjesë e kësaj, organizatat e mëposhtme ofrojnë mbështetje në varësi të vendndodhjes aktuale të individit:

- The Salvation Army (Angli dhe Uells)
- Tara and Migrant Help (Skoci)
- Migrant Help (Irlandë e Veriut).

Ti ke të drejta

Mund të kesh frikë, të ndihesh e pafuqishme dhe vetëm. Megjithatë, ekziston ndihma dhe ti ke të drejta dhe mundësi zgjedhjeje. Ti ke të drejtë për:

- ndihmë të pavarur emocionale, mjekësore dhe praktike. Në këtë mbështetje mund të përfshihet:
 - gjetja e një akomodimi të përkohshëm dhe të sigurt.
 - ndihma në lidhje me trajtimin mjekësor.

- caktimi i dikujt që do të të ndihmojë të përballosh gjendjen tënde.
- mundësimi i një përkthyesi/interpretuesi që do të të ndihmojë të komunikosh në anglisht.
- mbrojtje: trafikimi i qenieve njerëzore është krim. Nëse zgjedh ta denoncosh atë në polici ata duhet të të përgjigjen.
- Këshillim ligjor të pavarur.

Mund të marrësh këshillim nga këshilluesi yt ligjor ose nga një zyrë për këshillimin e qytetarit rreth kompensimit që mund të pretendosh. Nëse ke një punonjës për mbështetje, ai do të mund të të ndihmojë për të marrë këtë këshillim.

Shtetasit jo britanikë apo të Zonës Ekonomike Evropiane nuk do të largohen nga MB-ja gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit. Nëse identifikohesh si viktimë e trafikimit, mund të të marrin në konsideratë për leje qëndrimi të përkohshme.

Nëse nuk je shtetas britanik apo nga Zona Ekonomike Evropiane (dhe nuk ke të drejtë qëndrimi në MB) atëherë do të marrësh asistencë për t'u kthyer në vendin tënd, nëse kjo gjë është e sigurt.

Çfarë ndodh nëse vendos t'ia tregoj eksperiencën time policisë?

Policia do të:

- flasë me ty për atë që ka ndodhur
- të ofrojë mbrojtje nga ata që të kanë lënduar
- fillojë një hetim
- të mbajë të informuar.

Për ndihmë dhe mbështetje kontakto:

Angli dhe Uells:

The Salvation Army Human Trafficking
Helpline

☎ 0300 3038151

Irlandë e Veriut dhe Skoci:

Migrant Help

☎ 07766 668781

Skoci:

TARA

☎ 0141 276 7724

Policinë:

☎ 999



HM Government

Ndihma për viktimat e rritura të trafikimit të qenieve njerëzore

Të drejtat e tua nëse je trafikuar
për qëllime shfrytëzimi në
Mbretërinë e Bashkuar



Për ndihmë dhe mbështetje
kontakto: The Salvation Army
Human Trafficking Helpline

0300 303 8151